



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 17

Prishtinë, më 27.02.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S/2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Nezir Çoçaj dhe Bilall Sherifi

Munguan: Glauk Konjufca, Igor Simić, Shkumbin Demaliaj dhe Korab Sejdiu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Fitim Sadiku POLIS, Sanije Berisha OSCE, Agnesa Haxhiu KDI, Shefki Kastrati NDI, Valbona Bytyqi EkonomiaOnline, Blerim Sallahu GP VV, Rreze Hoxha GLPS, Rinor Beka NDI, Muhamet Shehu Kosova Sot;

Mbledhjen e kryesoi,

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projekt-Rregullores së Kuvendit;
3. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Komisionit Kosovar për Kërkesa Pronësore, dhe për anëtarë për Verifikim dhe Vendosi të Pronave;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-030 për aktet juridike;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja-njoftoi anëtarët e komisionit që në pikën të ndryshme është edhe procedimi i Ligjit për Presidentin si dhe diskutimi për dy dëgjime publike, për Projektligjin për Konfliktin e Interesit dhe degjimi publik për Pakon Ligjore që rregullon perfitimin e zyrtarëve të lartë.

Rendi i dites u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Shqyrtimi në parim i Projekt-Rregullores së Kuvendit;

Hajdar Beqa-meqënëse si komision kemi votuar draftin e rregullores, deputeti Beqa kërkoi mbështetjen e komisionit që të miratohet në parim dhe shqyrtimi i parë të bëhet në seancën e radhës me shmangie nga afati procedural i paraparë nga neni 56 paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit.

Albulena Haxhiu-tha se për shkak të aktgjyqimeve të Gjykatës Kushtetuese në raport me Grupin Parlamentar si dhe me Imunitetin e Deputetëve kemi qenë të penguar të punojmë në draft rregullore pikërisht për këto dy çështje. Deputetja Haxhiu vërejtje kishte edhe të konferenca e kryetarëve ku tha se nuk është pajtuar që në konferencën e kryetarëve të jenë edhe nënkryetarët e kryesisë sepse kjo do të ishte ngarkesë dhe pastaj po rezulton me jo-produktivitet. Ajo tha se këtë çështje do ta adresojë si vërejtje në seancën parlamentare gjatë shqyrtimit por megjithatë do ta përkrahë në parim këtë draft rregullore. Në vazhdim tha se çështja tjetër që kemi pasur probleme në praktikë ka të bëjë me pyetjet parlamentare ku tha se ministrat, kryeministri shpesh herë nuk përgjigjen në pyetjet parlamentare, ajo tha se përveç vërejtjes publike që i bëhet ministrit nëse nuk e ka arsyetuar mungesën e tij në seancën parlamentare, nuk ka ndonjë sanksion tjetër. Kjo çështje duhet të adresohet me amendamente shtesë, gjithashtu permendi edhe mandatin e deputetit dhe disa çështje tjera ku tha se duhet të ngriten në seancën parlamentare.

Hajdar Beqa-propozoi që të shkohet me dy votime, propozimi i parë ishte, të votohet në parim Draft-Rregullorja dhe propozimi i dytë që të votohet për shmangie nga rregullorja. Të gjithë anëtarët e komisionit u pajtuan me këto propozime.

Komisioni bëri votime të ndara, *Për propozimin e z. Hajdar Beqa për shmangie nga afatet procedurale, komisioni me katër vota për dhe dy kundër, vendosi që ti rekomandoi Kuvendit që shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores në Kuvend të bëhet në seancën plenare të radhës, me shmangie nga afatet procedurale, të parapara me nenin 56, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit.*

Kurse për miratimin, në parim, të Projekt-Rregullores së Kuvendit, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projekt-Rregullorja e Kuvendit.

3. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Komisionit Kosovar për Kërkesa Pronësore, dhe për anëtarë për Verifikim dhe Vendosi të Pronave;

Komisioni, shqyrtoi propozimet e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, për emërimin e anëtarëve në Komisionin për Verifikim dhe Vendosije të Pronave. Për këtë pozitë Gjykata Supreme kishte propozuar z.Betim Shala, avokat, z. Sylejman Nuredini, ish- gjyqtar, prof.dr.Abdullah Aliu, ligjërues në Fakultetin Juridik të UP “Hasan Prishtina” dhez. Shpëtim Sadiku, avokat. Komisioni pasi shqyrtoi propozimet, vlerësoi se propozimet për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije të Pronave, janë në pajtim me nenin 9, të Ligjit 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,

R e k o m a n d i m

- I. Të emërohen anëtarë të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije të Pronave, dy nga katër kandidatët e propozuar;
1. Betim Shala,
 2. Sylejman Nuredini,
 3. Abdullah Aliu,
 4. Shpëtim Sadiku.

Po ashtu, Komisioni shqyrtoi propozimet e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore. Për këtë pozitë Gjykata Supreme ka propozuar Prof.Asoc.Dr. Rustem Qehaja, ligjërues në Fakultetin Juridik të UP “Hasan Prishtina” dheznj. Lule Bilalli- Imeri, avokate. Komisioni pasi shqyrtoi propozimet vlerësoi se propozimet për emërimin e anëtarëve ne Komisionin për Kërkesa Pronësore janë në pajtim me nenin 8, tëLigjit nr. 05/L-010, për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, dhe vendosi që Kuvendit të Republikës së Kosovës t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

- I. Të emërohet anëtarë i Komisionit për Kërkesa Pronësore njëri nga dy kandidatët e propozuar:
1. Rustem Qehaja,
 2. Lule Bilalli- Imeri.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-030 për aktet juridike;

Kryetarja, paraqiti para Komisionit Projektligjin nr. 06/L-030 për aktet juridike, ajo kishte vërejtje për këtë Projektligj sepse theksoi se bie ndesh me kushtetuten kur dihet se kushtetuta përcakton aktet që nxirren nga kuvendi, presidenti, qeveria dhe institucionet tjera. Deputaja Haxhiu tha se ky projektligj nuk duhet miratuar nga kuvendi, gjithashtu kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Arben Gashi-tha se në mënyre që të mos i bëhet një refuzim nga ana jonë si komision këtij Projektligji është mirë që të ftohet propozuesi që të arsyetojë projektligjin,të shihet se sa mund të bëhen përmirësime në këtë projektligj që të mos ketë mospërputhje pastaj theksoi deputeti Arben Gashi.

Hajdar Beqa-tha se për këtë projektligj janë dy rrugë e para është që të ftohet përfaqesuesi i zyres ligjore që të jep sqarime në lidhje me këtë projektligj dhe e dyta që t’i propozohet kuvendit që ky projektligj të mos miratohet.

Pas diskutimeve komisioni vendosi qe në një takim të radhës te ftohet përfaqësuesi i zyrës ligjore dhe te jep sqarime shtese lidhur me këtë projektligj, ne mënyre qe pastaj komisioni te jep rekomandim per seance.

5. Të ndryshme;

Në këtë pikë kryetarja tha se, Projektligji për Presidentin është përfunduar nga komisioni për legjislacion dhe komisionet tjera dhe i plotëson kushtet të procedohet për Kuvend.

Ndërsa Komisioni vendosi që të mbahet dëgjim publik për Projektligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit me datë 14.03.2018, ndërsa me 07.03.2018 të mbahet dëgjim publik për Pakon Ligjore për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:48

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu

